

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT

“Fabrike perpunimi qumeshti”



Subjekti: “Klegen” sh.p.k

Vendndodhja: Fshati Dobrac, komuna Rrethina, Shkoder

Pergatiti materialin: Eko-Studio-Projekt sh.p.k

ADMINISTRATORI: Shkëlzen MADANI

Tirane, 2016



PERMBAJTJA

✚ Hyrje

✚ Baza ligjore

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Fabrike perpunimi qumeshti”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- Ligji nr. 10 431, date. 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji nr. 10266 date 15.04.2010 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji nr 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit"
- Ligji nr. 9010, date.13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji nr. 116/2014 “Per akreditimin e laboratoreve testues kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues ne Republiken e Shqiperise”
- VKM Nr.435, date.12.09.2002 “Per normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
- VKM Nr.103, date. 31.03.2003 “Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise”
- VKM Nr.177, date. 31.03.2005 “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengta dhe kriteret e zonimit te mjedisive ujore pritesa”
- Ligji Nr.9115, date. 24.07.2003 “Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotur “
- VKM Nr. 248, date 24.04.2003 “Per miratimin e normave te perkohshme te shkarkimeve ne ajer dhe zbatimin e tyre”
- Ligji nr.8094 date 21.03.1996 “Per largimin publik te mbeturinave”



- VKM 1189, date 18.11.2009 “Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e Programit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit”
- Udhëzim, Nr.8, dt.27.11.2007 “Për nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti "Klegen" sh.p.k me numer NIPT-I J77319030R do te ushtroje aktivitetin e perpunimit te qumeshtit.Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te tipit B.

Pershkrimi i qellimit te propozuar

Subjekti "Klegen" sh.p.k Shkoder eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne vitin 1998. Ky subjekt ushtron veprimtarine e tij ne fushen e perpunimit te qumeshtit.Fabrika per perpunimin e qumeshtit ndodhet ne fshatin Dobrac, komuna Rrethina, Shkoder.Per zhvillimin normal te ketij aktiviteti punojne rreth 30 punetore. Kapaciteti i prodhimit tequmeshtit ne kete fabrike do te jete rreth 8-10 ton/dite.

KOORDINATAT E VENDNDODHJES

Numri	Koordinata X	Koordinata Y
1.	4376887	4661974
2.	4376907	4661942
3.	4376879	4661971
4.	4376904	4661942

Pershkrimi i procesit te punes

Proçesi i punës në shoqerine “KLEGEN”, fillon me pranimin e lendes se pare qe eshte qumeshti i cili mblidhet ne ferma te ndryshme dhe ku me pas ne fabrike fillon procesi i pasterizimit, analizimi i parametrave dhe prodhimi i nenprodukteve te qumeshtit. Pasterizimi behet ne nje temperature 75⁰C. E me nje skremim ne baze te produktit te prodhuar 0.5%, 1.5%, 3.5% yndyre

Më konkretisht, këtu përfshihen:

- Homogjenizimi
- Paketimi
- Kontrolli i cilesise dhe hedhje ne treg e qumeshtit dhe nenprodukteve te tij




Në Laboratorin e brendshëm “KLEGEN” sh.p.k kryen të gjitha analizat e lëndës së parë dhe produktit të gatshëm sipas një standarti shumë të lartë. Laboratori kryen kontroll të vazhdueshëm, parandalues, në çdo fazë të ciklit të prodhimit:

- **Lënda e parë**; duke filluar nga çasti kur qumeshti vjen në fabrikë
- **Produkte në proces**; në momente të ndryshme të procesit teknologjik
- **Ambienti**; si brenda ashtu dhe jashtë (temperatura, lagështia, ajrosja, etj.)
- **Produkti i gatshëm**; Qumeshti dhe nenproduktet e tij

Analizat që kryhen në këtë laborator mund të klasifikohen në dy grupe kryesore:

1. Në grupin e Parë të analizave fiziko-kimike, përfshihen analizat, që kryhen mbi lëndën e parë (qumesht).
Këtu bëjnë pjesë analizat e përmbajtjes së proteinës, yndyrës.
2. Grupi i dytë i analizave mikrobiologjike konsiston në kontrollin për infeksione dhe parandalimin e tyre. Ky kontroll bëhet në tre linja:
 - Mjediset e fabrikes
 - Tanket e qumeshtit
 - Analizat e drejtpërdrejta në qumesht
 Këto kontrolle kanë karakter parandalues të mikrobeve që mund të futen dhe të dalin nga fabrika.

Gjatë realizimit të procesit të prodhimit të qumeshtit, në mënyrë paralele, me orare të caktuara, kryhet mbledhja e qumeshtit, në qendrën e grumbullimit. Qumeshti transportohet në qendrën grumbulluese, nëpërmjet një sistemi plotësisht automatik. Ky sistem kontrollohet drejtpërdrejt nga departamenti i grumbullimit.



Pas grumbullimit, sipas kategorive të përcaktuara në standart, qumeshti ambalazhohet, etiketohet dhe magazinohet. Më pas, qumeshti kalon në procesin e shitjes. Transporti kryhet me mjetet e firmes deri në destinacionin final në kushte frigoriferike në temperaturën 4-6 °C. Është kërkesë e firmes që po kështu të ruhet nga konsumatori. Në fabrikën “KLEGEN” përpunohet



qumesht i grumbulluar nga fermat dhe trajtohet nepermjet nje teknologjie bashkohore dhe moderne. I gjithë procesi nga marrja e qumeshtit deri ne paketim kryhet me cikel te mbyllur. Ne fabrike zbatohet standarti nderkombetar EU-ISO 22000:2005.Makineria e paketimit te qumeshtit realizon larjen, mbushjen, mbylljen e tapave,etiketimin, daten e skadimit dhe paketimin me koli ne menyre automatike.Pasterizatori eshte i kompletuar me sistem automatik sipas kerkesave te BE, realizon pasterizimin e qumeshtit sipas kerkesave te teknologjise se produktit.Makineria e paketimit te kosit me gota realizon mbushjen, mbylljen me kapak, daten e skadimit dhe vendosjen ne arka ne menyre automatike.Homogjenizatori siguron shperndarjen e nyndres ne menyre uniforme ne te gjithë qumeshtin. Persa i perket higjenes ne fabrike sigurohet cdo dite larja me solucione lares-dizinfektues te garantuar dhe shume efektiv.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Shkodra shtrihet për rreth 16,46 km² në një hidrografike me pranë liqenit me të njëjtin emër dhe lumenjtë Drin, Bunë dhe Kir në një ultësirë të "mbrojtur" nga liqeni, Alpet Shqiptare në lindje ku spikasin majat e Cukalit (1.722 m), Maranaj(1.576 m), Sheldies (mali Sardonik i Barletit; për nga Shurdhahu) dhe Taraboshit (rreth 700 m) në perëndim dhe deti Adriatik. Në një rreze prej 45 km mund të arrihen ranishtet në Adriatik, shëtitjet e alpinizmi në Alpe, e kanotazhi nepër lumenj.

Kushtet klimatike

Shtrirja në mes të një relievi fushor, kodrinor, paramalor dhe malor, afërsia me Detin Adriatik dhe liqenin e Shkodrës kanë përcaktuar edhe klimën e saj, një klimë mesdhetare me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare në vit variojnë nga 14,5 °C deri ne 16,8 °C. Temperatura në Janar është nga 1,9 °C deri në 9 °C. Në dimër fryn era e murlanit (erë lokale), e ftohtë, e fortë dhe e thatë, ndërsa në fund të vjeshtës fryn era e shirokut, që shoqërohet me reshje dhe fryrjen e lumenjve. Sasia e reshjeve në këtë qytet është e madhe. Mesatarisht aty bie 2000 mm shi në vit, pra një nga zonat më të lagështa të Shqipërisë.



Relievi

Shkodrës i takojnë 13 maja në Alpe, që i kapërcejnë të 2000m lartësi si: Jezerca (2694m), Papluka, Mali i Vilës, Radohima (2570m), Mali i Shënikut (2550m) si dhe Biga e Gimajve (mbi 2200m) etj. Krahas këtyre majave në Shkodër gjenden male të tjera më të ulëta si Taraboshi (595m), Shita e Hajmelit e deri te kodrat e Bushatit, të Bërdicës, të Kodhelit, të Kakarriqit, të Rrencit e të Tepes. Ndër luginat më të bukura në rrethin e Shkodrës është lugina e Shalës (e përbërë nga dy lugina të vogla: lugina e Kopreut dhe lugina e Thethit), lugina e Kirit dhe lugina e Përroit të Thatë.

Hidrografia

Rajoni i Shkodrës është i njohur për burime të pasura hidrografike. Janë lumenjtë Drini 285 km, Buna 44 km (i vetmi lumë i lundrueshëm), Kiri 51 km, Shala që përbëhet nga dy përrenj, Cemi, dhe burimet ujore. Përveç lumenjve, është e pasur edhe me liqene: Liqeni i Shkodrës zë një sipërfaqe 368 km² nga e cila 149 km² përfshihet brenda territorit të Shqipërisë. Është liqen i cekët, me florë e faunë shumë të pasur. Në këtë liqen jetojnë 50 lloje peshqish. Në brigjet e tij shtrihen fshatrat turistike të Shirokës dhe të Zogajt. Liqeni është preferenca e çdo shkodrani. Krahas liqenit të Shkodrës kemi tre liqene artificiale: Liqeni i Vaut të Dejës, liqeni i Komanit dhe Liqeni i Shtodrit.

Flora dhe fauna

Shkodra ka një florë dhe faunë shumë interesante, rreth 1900 lloje bimësh dhe 3500-4000 specie shtazore. Ky qytet është ndër të rrallët që natyra i ka falur fushat pjellore, lumenjtë plot ujë, liqenin e mrekullueshëm e kodrat e gjelbëruara.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.



Shkarkimet dhe mbetjet qe prodhohen

Shkarkimet ne ambient i klasifikojme sipas natyres se tyre:

Shkarkimet ne ajer

Gjate procesit te punes nuk ka shkarkime te gazeve te demshem ne atmosfere dhe nga matjet e kryera me aparatura specifike dhe efikase u verejten nivele te pranueshem te ketyre gazeve ne ajer. Vetem ne rastin e perdorimit te kaldajes ka clirime te CO_x te cilat jane brenda normave. Ambjentet e punes jane te pajisura edhe me aspiratore ne menyre qe te bejne te mundur qarkullimin e ajrit.

Shkarkimet e lengeta

Gjate zhvillimeve te proceseve te larjes se tankeve, ujerat e perdorur dekantojne ne gropa te posacme perpara se te shkarkohen ne kanalizime. Ne keto ujera nuk ka shkarkime te lengeta te rrezikshme per mjedisin uhor prites.

Shkarkimet e ngurta:

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk kemi mbetje te ngurta qe te sjellin ndotje te tokes. Te vetmet mbetje qe krijohen vijne nga aktiviteti i perditshem i personelit si dhe nga ambalazhet te cilat depozitohen ne vendin e caktuar per tu larguar me pas ne vendet e caktuar nga pushteti lokal.

Zhurmat (ose ndotje akustike)

Gjate zhvillimeve te proceseve teknologjike, ne ambientin brenda dhe ne perimetrin e rrethimit te kompanise, zhurmat jane ne nivele te pranueshme dhe brenda normave te lejuara. Shoqeria eshte kujdesur te importoje nga jashte makineri bashkekohore dhe ne gjendje te mire teknike, ne menyre te tille qe zhurmat e krijuara prej tyre te mos sjellin ndotje akustike dhe te jene te demshme per mjedisin dhe shendetin e punonjesve.

4. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Jane marre te gjitha masat per sa u perket shkarkimeve ne toke, uje e ajer sipas normave ligjore:

- Mbetjet e krijuara gjate aktivitetit te perditshem depozitohen ne vend te caktuar per tu larguar me pas per ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.
- Ujerat perpara se te derdhen ne mjedisin uhor prites dekantojne
- Persa i perket shkarkimeve ne ajer ky aktivitet nuk gjeneron fare gaze ne atmosfere vec kaldajes kur eshte ne gjendje pune por qe emetimet e CO_x jane brenda normave te lejuara.



- Per levizjen e ujerave te shiut eshte ndertuar sistemi i drenazhimit ndersa persa i perket ujerave te bardha dhe te ndotura urbane ato i bashkohen sistemit te kanalizimit te vendosur nga pushteti lokal.
- Perreth fabrikes eshte bere sistemimi i ambientit per qellim mbrojtjen e peisazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te perhershem si dhe me lule decorative.Po ashtu eshte bere dhe shtrimi i sheshit para fabrikes.Nga ana e personelit tregohet nje kujdes i vecante per mirembajtjen e tyre.
- Persa i perket lendeve ndotese qe mund te derdhen ne mjedis,jane marre masa per pastrimin e menjehershem duke mos shkaktuar keshtu ndotje te padeshirueshme.
- Jane marre masa paraprake per pastrimin e ujerave teknologjik para se ato te kalojne ne rrjet.
- Ujerat qe perdoren gjate proceseve te prodhimit, monitorohen dhe disiplinohen perpara shkarkimit ne mjedis, ne menyre te tille qe niveli i yndyrnave, lendeve pezull, ph si dhe temperatura e ujit te mos jete mbi nivelet e caktuara dhe te demtoje mjedisin uJOR prites.Uji perdoret vetem per raste te duhura.
- Mbetjet e ngurta transportohen me mjete te vecante ne vendet e paracaktuara nga pushteti lokal.
- Jane marre masa per parandalimin e zjarrit duke vendosur tabela per perdorimin e fikeseve te zjarrit.
- Trajnimi i punetoreve behet ne menyre te vazhdueshme, kjo ndihmon qe siguria teknike te jete sa me e mire.Gjithashtu ne menyre rigoroze nga personeli zbatohen rregullat e higjienes ne ambientet e fabrikes se perpunimit te qumeshtit dhe prodhimit te nenprodukteve te tij.
- Per kushtet e punes jane marre masa per sigurimin teknik ne ambientet e kompanise, si dhe sistemimin e ambjenteve te punes dhe ajrosjen e ventilimin e tyre.Zbatohet ne menyre rigoroze rregullorja e higjienes se vendit te punes.
- Mbetjet nga ambalazhet depozitohen ne vende te posacme dhe evadohen vazhdimisht per ne vendet e percaktuara nga Pushteti Lokal.

MBROJTJA NGA ZJARRI

Per tu mbrojtur nga zjarri me projekt jane vendosur ne territorin e objektit hidrante uji dhe fikse shkume.Hidrانتet furnizohen me uje nga tubacione celiku dhe mbulojne teresisht territorin e jashtem dhe te brendshem te objektit.

SIGURIMI TEKNIK

Mbrojta e shendetit dhe siguria ne pune jane ne qender te vemendjes te shoqerise. Per te mbajtur nje regjim te forte te sigurise ne pune dhe shendetit te plote te punonjesve do te merren masat e meposhtme:

Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.

Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialiste te profesioneve qe kerkohen.

Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.



Masat per mbrojtjen nga zjarri do te jene pjese e instruksioneve e te tabelave lajmeruese e parandaluese.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Vlerësohet puna e bërë nga drejtuesit e kompanisë “KLEGEN” sh.p.k. në drejtim të disiplinimit të veprimeve në mbajtjen e vlerave të intervenimit të agjentëve kimik, fizike e biologjik në mjediset e punës dhe në impaktin në mjedis të këtyre elementëve, duke përdorur teknologji moderne dhe të standarteve bashkohore.
- Ujerat e përdorur dekantohen në gropa të posaçme përpara se të shkarkohen në kanalizime. Në këto ujera nuk ka shkarkime të lëngëta të rrezikshme.
- Gjatë zhvillimit të procesit të punës, te perpunimit te qumeshtit dhe prodhimit te produkteve te tij nuk kemi shkarkime te gazeve ne ajer qe ta ndotin ate.
- Në ambientet e prodhimit të “KLEGEN” sh.p.k zbatohen rregullat e sigurimit teknik në punë dhe punohet për krijimin e kushteve optimale të punës. Shoqëria ka pajisur punetoret me uniforma si dhe kapele te bardha per te respektuar rregulloren e higjenes ne pune.
- Shoqëria realizon trajtimin e ujerave qe dalin nga proceset e punes perpara se ato te shkarkohen ne mjedisin uxor prites.
- Janë marrë masa për sigurimin teknik në ambientet e kompanisë, si dhe sistemimin e ambienteve të punës dhe ajrosjen e ventilimin e tyre.
- Mbetjet nga ambalazhet e ngurta depozitohen në vende të posaçme dhe evadohen vazhdimisht për në vendet e përcaktuara nga Pushteti Lokal.
- Është ndërtuar dhe funksionon sistemi i drenazhimit dhe lëvizjes së ujerave te bardha.
- Zbatohet ne menyre rigoroze rregullorja e higjenes se vendit te punes.

Rekomandime

- Te njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- Për të bërë të mundur disiplinimin e të gjithë ujerave dhe për të ulur në maksimum impaktin në mjedis te tyre duhen pastruar ne menyre periodike gropat dekantuese.
- Të merren masa për të parandaluar rënien e zjarrit dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (depozite uji, zjarrefikëse të lëvizshme etj.)

PER “EKO-STUDIO-PROJEKT” sh.p.k
Punoi: Msc.Ing.mjedisi Ana Naçi

